| <p>në biznes, të lidhë kontrata, të paguajë taksat, të padisë dhe të paditet.</p> <p>1.48. Maturim - data kur borxhi ka arritur për pagesë dhe duhet paguar në tërësi.</p> <p>1.49. Ekspert - është një profesionist i kualifikuar me njohuri të posaçme, të provuara në një fushë të caktuar, i pavarur nga palët dhe i regjistruar si i tillë në regjistrin e ekspertëve gjyqësor. Në rastet kur fusha e ekspertizës nuk mbulohet nga regjistri i ekspertëve të mbajtur nga gjykata, "Ekspert" do të kuptohet profesionisti i kualifikuar, me njohuri të posaçme të provuara në një fushë të caktuar, që paraqitet në një procedurë gjyqësore për të dhënë opinionin e tij të pavarur në atë fushë specializimi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Fushëveprimi</p> <p>1. Ky ligj është i zbatueshëm vetëm ndaj Shoqërive Tregtare të rregulluara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare ose me një ligj</p> | <p>business, enter into contracts, pay taxes, can sue and be sued;</p> <p>1.48. Maturity- the date when the debt is due for payment and must be paid in full.</p> <p>1.49. Expert - is a qualified professional with special, proven knowledge in a certain field, independent of the parties and registered as such in the register of judicial experts. In cases where the field of expertise is not covered by the register of experts kept by the court, "Expert" shall be understood as the qualified professional, with proven special knowledge in a certain field, who appears in a judicial procedure to give the opinion of his independent work in that field of specialization.</p> <p style="text-align: center;">Article 3 Scope</p> <p>1.This Law applies only to Business Organizations, as defined in the Law on Business Organizations or any other future</p> | <p>Republike Kosovo;</p> <p>1.48. Dospeće – datum na koji dug dospeva za naplatu i mora biti plaćen u celosti.</p> <p>1.49. Veštak – je kvalifikovano lice koje ima specijalno, dokazano znanje iz određene oblasti, koje je nezavisno od strana i upisano kao takvo u registar sudskih veštaka. U slučajevima u kojima oblast veštačenja nije obuhvaćena registrom veštaka koji vodi sud, za „veštaka“ se smatra kvalifikovani profesionalac koji ima dokazano specijalno znanje iz određene oblasti, koji se pojavljuje u sudskom postupku radi davanja mišljenja o svom nezavisno obavljenom radu u datoj grani specijalizacije.</p> <p style="text-align: center;">Član 3. Delokrug</p> <p>1.Ovaj zakon primenjuje se samo za privredna društva, kako je definisano u Zakonu o privrednim društvima ili nekom</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|---|--|
| <p>pasardhës.</p> <p>2. Nuk mund të jenë debitor sipas këtij ligji:</p> <p>2.1. institucioneve të Republikës së Kosovës;</p> <p>2.2. cilitdo organ qeveritar;</p> <p>2.3. institucioneve financiare sipas përcaktimeve të ligjit që rregullon bankat, institucionet financiare dhe institucionet financiare jobankare; dhe</p> <p>2.4. kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësve të sigurimeve të cilët rregullohet me ligj të veçantë për kompanitë e sigurimeve dhe ndërmjetësit e sigurimeve;</p> <p>2.5. fondeve pensionale ose ofruesve të skemave pensionale, të licencuara dhe rregulluara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;</p> <p>2.6. ndërmarrjeve shoqerore nën administrim të Agjencionit Kosovar të Privatizimit;</p> | <p>Law.</p> <p>2. The following, can not be debtor under this law.</p> <p>2.1. institutions of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.2. any governmental unit;</p> <p>2.3. financial institutions as defined in Law regulating Banks, Microfinance Institutions And Non-Bank Financial Institutions; and</p> <p>2.4. insurance companies and insurance intermediaries as defined in the law regulating the Licensing of Insurance Companies and Insurance Intermediaries;</p> <p>2.5. pension funds or providers of pension schemes licensed and regulated by the Central Bank of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.6. socially owned enterprises under the administration of Privatization Agency of Kosovo;</p> | <p>drugom budućem zakonu.</p> <p>2. Prema ovom zakonu dužnik nemože biti:</p> <p>2.1. institucije Republike Kosovo;</p> <p>2.2. bilo koji vladin organ;</p> <p>2.3. finansijske institucije kako je definisano u zakonu koji uređuje banke, finansijske institucije i nebankarske finansijske institucije; i</p> <p>2.4. osiguravajuća društva i posrednike u osiguranju kako je definisano u zakonu koji uređuje osiguravajuća društva i posrednike u osiguranju;</p> <p>2.5. penzione fondove ili ponuđače penzionih šema, koje je licencirala i uredila Centralna banka Republike Kosovo;</p> <p>2.6. društvena preduzeća pod upravom Kosovske agencije za privatizaciju;</p> |
|---|---|--|

| | | |
|--|---|--|
| <p>2.7. ndërmarrjet publike të rregulluara më Ligjin për ndërmarrjet publike ose më një ligj pasardhës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Parimet e përgjithshme të ligjit për falimentimin</p> <p>1.Gjatë zbatimit dhe interpretimit të këtij ligji, gjykata aplikon parimet e përgjithshme të ligjit për falimentimin, të përcaktuara në këtë nen. Gjatë procedurës së falimentimit, gjykata i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme mbi bazën e parimeve si ne vijim:</p> <p>1.1.përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit maksimizon kthimin e përgjithshëm të pasurisë në favor të kreditorëve;</p> <p>1.2. shpërndarjet ndaj të gjithë kreditorëve të kategorisë së njëjtë të prioriteteve bëhen sipas parimit pari passu;</p> <p>1.3. debitori person juridik nuk do të jetë pronar i asetëve të tij në përfundim të procedurës së likuidimit dhe do të fshihet si biznes aktiv në regjistrin e bizneseve me shënimin “i likuiduar”;</p> | <p>2.7. publicly owned enterprises as defined by the Law on Publicly Owned Enterprises or any other future Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 General principles of the Law on bankruptcy</p> <p>1.In implementing and interpreting this Law, the court shall apply the general principles of the Law on bankruptcy, defined in this Article. In bankruptcy proceedings, the court shall take steps to ensure the following principles:</p> <p>1.1.the bankruptcy estate representative seeks to maximize the overall return to all creditors;</p> <p>1.2. all creditors of equal priority share in all distributions pari passu;</p> <p>1.3. the debtor a legal person, shall not be the owner of its assets at the conclusion of the liquidation proceeding and shall be removed as active business from the registry of</p> | <p>2.7.javna preduzeća kako su definisana Zakonom o javnim preduzećima ili drugim budućim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 4. Opšti principi Zakona o stečaju</p> <p>1. Pri sprovođenju i tumačenju ovog zakona sud primenjuje opšta načela Zakona o stečaju koja su određena u ovom članu. U stečajnom postupka, sud preuzima mere kako bi obezbedio sledeća načela:</p> <p>1.1.da zastupnik stečajne mase maksimizira ukupni povraćaj imovine u korist poverioca;</p> <p>1.2.da se jednaka raspodela svim poveriocima jednakog prioriteta vrši po principu pari passu;</p> <p>1.3.Ukoliko je dužnik poslovni subjekat, na završetku stečajnog postupka neće više biti vlasnik imovine, neće više biti naveden kao aktivan i biće izbrisan iz poslovnog</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>1.4.debitori individual nuk do të jetë pronar i aseteve të tij të shfrytëzuara për biznes të cilat janë administruar gjatë procedurës së falimentimit, në përfundim të procedurës së likuidimit. Fakti se debitori individual ka falimentuar shënohet në regjistrin e bizneseve gjatë çdo regjistrimi të ri të një biznesi nga debitori dhe anëtarët e ngushte të familjes për pesë vite nga dita e përfundimit të procedurës së falimentimit dhe fakti se debitori individual ka falimentuar shënohet edhe në regjistrin e kredive të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,</p> <p>1.5.procedura e falimentimit është procedurë urgjente;</p> <p>1.6.nuk lejohet asnjë lloj pezullimi apo ndërprerje e procedurës së falimentimit.</p> <p>1.7.Procedura e falimentimit do të ndiqet në mënyrë që të sigurohet sa më shumë që të jetë e mundur vlerat e aseteve dhe</p> | <p>businesses with the designation “liquidated”;</p> <p>1.4. the individual debtor shall not be the owner of its business assets administered in the bankruptcy proceeding, at the conclusion of the liquidation proceeding. The fact that the individual debtor has bankrupted shall be noted in the business registry in every new registration of a business by the debtor and close family members for five (5) years from the day of conclusion of the bankruptcy proceeding and the fact that the individual debtor has bankrupted shall be noted in the Credit Registry of the Central Bank of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. bankruptcy proceeding shall be an urgent proceeding;</p> <p>1.6. there is not allowed any kind of suspension or interruption of bankruptcy proceeding.</p> <p>1.7. The bankruptcy procedure shall be conducted in order to secure as much as possible the values of the assets and the</p> | <p>registra uz belešku „Likvidiran“;</p> <p>1.4.ukoliko je dužnik pojedinac, na završetku stečajnog postupka pojedinac neće više biti vlasnik i uživatelj poslovne imovine kojom se upravljalo u postupku. Stečaj individualnog dužnika beleži se u registar svih poslovanja prilikom svake nove registracije novog biznisa dužnika i članova njegove uže porodice u narednih pet (5) godina od dana završetka stečajnog postupka, a činjenica da je individualni dužnik likvidiran beleži se u kreditni registar Centralne banke Republike Kosova;</p> <p>1.5.procedura stečaja je hitna procedura;</p> <p>1.6.nije dozvoljena nijedna vrsta obustave ili prekida stečajnog postupka.</p> <p>1.7.Stečajni postupak sprovodi se kako bi se postigla najveća moguća vrednost imovine i najveći mogući</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>shkalla më e lartë e mundshme e shlyerjes së kreditorit brenda një afati sa më të shkurtër dhe me koston më të ulët të mundshme.</p> <p>2.Në procedurë të riorganizimit, gjykata duhet të siguroj që procedura e riorganizimit, nëse ka sukses, ka mundësi të:</p> <p>2.1.ruan vendet e punës ose krijon vende të reja të punës;</p> <p>2.2.ruan vlerën e asetëve deri në masën në përputhje me riorganizimin.</p> <p>3.Në të gjitha procedurat, gjykata duhet të marr masa të siguroj që:</p> <p>3.1.detyrimet e debitorëve dhe të drejtat dhe privilegjet e kreditorëve nuk mund të zhvlerësohen ose ndryshohen përveç kur parashihet me këtë ligj;</p> <p>3.2.të drejtat sendore të kreditorëve të siguar ose të kreditorëve të cilët kanë barra sendore nuk mund të zhvlerësohen ose ndryshohen përveç kur parashihet me këtë ligj;</p> | <p>highest possible rate of repayment of the creditor within the shortest possible time and at the lowest possible cost.</p> <p>2. In reorganization proceedings, the court shall take steps to ensure that the reorganization procedure, if successful will:</p> <p>2.1. preserves or creates jobs; and</p> <p>2.2. maintains or preserves asset values to the extent consistent with the reorganization.</p> <p>3. In all proceedings, the court shall take steps to ensure that:</p> <p>3.1. the obligations of debtors, and the rights and privileges of creditors, are not impaired or altered except as provided for in this Law;</p> <p>3.2. the rights in rem of secured creditors or creditors with separate satisfaction shall not be impaired or altered except as provided for in this Law;</p> | <p>stepen naplate od poverilaca u najkraćem mogućem roku, uz najniže moguće troškove.</p> <p>2.U proceduri reorganizacije, sud preuzima korake kako bi obezbedio da procedura reorganizacije, u koliko bude uspešna, može:</p> <p>2.1.sačuva radna mesta ili stvari nova;</p> <p>2.2.sačuva vrednost imovine u meri koja je u skladu sa reorganizacijom.</p> <p>3.U svim postupcima, sud treba da preduzme mere da obezbedi da:</p> <p>3.1.obaveze dužnika i prava i privilegije poverilaca, ne mogu se umanjeti ili promeniti osim kada se ovim zakonom predviđa;</p> <p>3.2.pravo nad stvarima obezbeđenih poverilaca ili poverilaca sa zalog u stvarima ne mogu da se devalviraju ili promene osim kada je zakonom predviđeno;</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>3.3.përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit do të marrë në posedim të gjitha asetet, të prekshme ose të pa prekshme, së bashku me të gjitha të drejtat, kërkesat ose detyrimet ndaj atyre aseteve, të krijuara si rezultat i ligjeve tjera, përveç nëse ndonjë dispozitë e këtij ligji përcakton ndryshe.</p> <p>3.4.në rastet e debitorëve individual, në procedurat e falimentimit, pasuria e falimentimit përfshin totalin e aseteve në pronësi të debitorit kur hapet procedura e falimentimit dhe pasuritë e fituara nga debitori gjatë procedurës së falimentimit.</p> <p>3.5. në përputhje me dispozitat për riorganizimin të përcaktuara në këtë ligj, hapja e rastit do të maturojë të gjitha kërkesave ndaj debitorit të cilat janë të pamaturuara në momentin e hapjes së rastit; dhe</p> <p>3.6. parimi i përgjegjësisë së kufizuar të aksionarëve të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, ortakëve të kufizuar në ortakëri të kufizuar dhe aksionarëve në shoqëritë aksionare do të respektohen në çdo rast</p> | <p>3.3.the bankruptcy estate representative, except as specifically provided for in this law, shall take all assets, tangible or intangible, subject to all rights, claims or obligations towards those assets, created as a result of other Laws;</p> <p>3.4. in the case of a debtor who is an individual, in bankruptcy proceedings, bankruptcy assets include the total assets owned by the debtor when the bankruptcy proceedings are opened and the assets acquired by the debtor during the bankruptcy proceedings.</p> <p>3.5. subject to the provisions on reorganization, the opening of a case shall mature all claims against the debtor which were unmatured as of the date of the opening of the case; and</p> <p>3.6. the principle of limited liability of shareholders of limited liability companies, limited partners in limited partnerships and shareholders in joint stock companies shall be respected in</p> | <p>3.3.zastupnik stečajne mase, preuzima svu imovinu, materijalnu ili nematerijalnu, zajedno sa svim pravima, zahtevima ili obavezama prema toj imovini, nastale kao rezultat drugih zakona, izuzev ukoliko neka od odredaba ovog zakona drugačije ne predviđa;</p> <p>3.4.kad je dužnik fizičko lice, stečajna masa u stečajnom postupku obuhvata ukupnu imovinu u svojini dužnika prilikom otvaranja stečajnog postupka i imovinu koju dužnik stekne u toku stečajnog postupka;</p> <p>3.5.u skladu sa odredbama o reorganizaciji, otvaranjem predmeta dospevaju sva potraživanja prema dužniku, koja nisu dospela na dan otvaranja postupka; i</p> <p>3.6. načelo ograničene odgovornosti akcionara društava sa ograničenom odgovornošću, komanditnog društva u komanditom i akcionara u akcionarskim društvima će se u</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p>dhe pronarët, ortakët ose aksionarët nuk do të jenë përgjegjës për detyrimet e shoqërive të tyre përveç në rastet kur ekziston një punë juridike, një garancion ose një ligj i veçantë që rregullon ndryshe këtë çështje.</p> <p>3.7. Në rastet e vdekjes së debitorëve individual, procedura e falimentimit vazhdon dhe zhvillohet nën supozimin se trashëgimtarët e debitorit individual, trashëgojnë edhe detyrimet sipas ligjit në fuqi për trashëgiminë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese</p> <p>1. Në procedurë të likuidimit, Administratori i falimentimit do të jetë përfaqësuesi i pasurisë falimentuese.</p> <p>2. Në procedurë të riorganizimit, debitori është përfaqësuesi i pasurisë falimentuese kur vepron si debitor në posedim.</p> <p>3. Gjykata edhe në procedurën e riorganizimit mund të emëron një Administrator të falimentimit i cili është përfaqësues i</p> | <p>any case and the owners, partners or shareholders shall not be liable for the obligations of their companies except in cases where there is a legal work, a guarantee or a special law that otherwise regulates this matter.</p> <p>3.7. In cases of death of individual debtors, the bankruptcy procedure continues and takes place under the assumption that the heirs of the individual debtor also inherit the obligations according to the law in force on inheritance.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Bankruptcy Estate Representative</p> <p>1. In liquidation procedure, the bankruptcy Administrator shall be the bankruptcy estate representative.</p> <p>2. In reorganization procedure, the debtor shall be the bankruptcy estate representative when acting as debtor in possession.</p> <p>3. Even in the reorganization procedure, the court may appoint a bankruptcy administrator who is a representative of the</p> | <p>svakom slučaju poštovati i vlasnici, ortaci ili akcionari neće odgovarati za obaveze svojih društava osim u slučajevima kada postoji pravni rad, garancija ili poseban zakon koji inače reguliše ovu materiju.</p> <p>3.7. U slučaju smrti dužnika pojedinca, stečajni postupak se nastavlja i odvija pod pretpostavkom da i nasljednici dužnika pojedinca nasljeđuju obaveze prema važećem zakonu o nasljeđivanju.</p> <p style="text-align: center;">Član 5. Zastupnik stečajne mase</p> <p>1. U postupku likvidacije, stečajni upravnik je zastupnik stečajne mase.</p> <p>2. U postupku reorganizacije, dužnik je zastupnik stečajne mase kada deluje kao dužnik u posedu.</p> <p>3. Čak i u postupku reorganizacije, sud može da imenuje stečajnog upravnika koji je zastupnik stečajne mase.</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p>pasurisë falimentuese.</p> <p>4. Autorizimet e përfaqësuesit të pasurisë falimentuese janë:</p> <p>4.1. do të administrojë me të gjithë pasurinë falimentuese;</p> <p>4.2. mund të padisë dhe të jetë i paditur në emër të pasurisë falimentuese; dhe</p> <p>4.3. kryen të gjitha detyrat e specifikuar në këtë ligj për përfaqësuesin e pasurisë falimentuese.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Juridiksioni i gjykatës dhe mjetet juridike</p> <p>1. Gjykata Komerciale është kompetente për zhvillimin e procedurës dhe shqyrtimin e rastit të falimentimit dhe për të gjitha çështjet e ndërlidhura me këtë ligj.</p> <p>2. Vetëm një palë e interesuar e cila është palë e prekur ose e dëmtuar nga një vendim i nxjerr nga gjykata ka të drejtën e ankesës në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës.</p> | <p>bankrupt estate.</p> <p>4. The bankruptcy administrator shall have the following authorizations:</p> <p>4.1. administer with all property of the bankruptcy estate;</p> <p>4.2. have the power to sue and be sued in the bankruptcy estate's name; and</p> <p>4.3. perform all duties specified in this law required to be performed by the bankruptcy estate representative.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Jurisdiction of the court and legal remedies</p> <p>1. The Commercial Court is competent for the development of the procedure and the review of the bankruptcy case and for all issues related to this law.</p> <p>2. Only an interested party who is a party affected or damaged by a decision issued by the court has the right to appeal to the Chambers of the Second Instance of the Commercial Court of the Republic of Kosovo.</p> | <p>4. Stečajni upravnik ima sledeća ovlašćenja:</p> <p>4.1. Da upravlja celokupnom imovinom stečajne mase;</p> <p>4.2. Da tuži i bude tužen u ime stečajne mase; i</p> <p>4.3. Obavlja sve dužnosti sadržane u ovom zakonu koje mora da vrši zastupnik stečajne mase.</p> <p style="text-align: center;">Član 6. Sudska nadležnost i pravni lekovi</p> <p>1. Privredni sud je nadležan da vodi postupak i razmatra stečajni predmet i za sva pitanja u vezi sa ovim zakonom.</p> <p>2. Pravo da uložiti žalbu Drugostepenom veću Privrednog suda Republike Kosovo ima samo zainteresovana strana na koju se ta odluka odnosi ili koja je tom sudskom odlukom oštećena.</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|---|---|
| <p>3. Secila palë e interesuar ka të drejtë ankese ndaj vendimeve përfundimtare të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.</p> | <p>3. Each interested party has the right to appeal against the final decisions of the Chambers of the First Instance of the Commercial Court, within a period of seven (7) days from the day of acceptance of the decision.</p> | <p>3. Svaka zainteresovana strana ima pravo žalbe na konačne odluke prvostepenih veća Privrednog suda u roku od sedam (7) dana od dana prijema odluke.</p> |
| <p>4. Përveç kur Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale vendosin ndryshe, ankesa ndaj një vendimi të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale nuk do të pezullojë zbatimin e vendimit nga Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale.</p> | <p>4. Unless the Chambers of the Second Instance of the Commercial Court decide otherwise, an appeal against a decision of the Chambers of the First Instance of the Commercial Court shall not suspend the implementation of the decision by the Chambers of the First Instance of the Commercial Court.</p> | <p>4. Osim ako Drugostepeno veće Privrednog suda ne odluči drugačije, žalba na odluku prvostepenih veća Privrednog suda ne zadržava izvršenje odluke prvostepenih veća Privrednog suda.</p> |
| <p>5. Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale vendos në afat prej shtatë (7) ditësh lidhur me ankesën.</p> | <p>5. The Chamber of the second instance of the Commercial Court decides within seven (7) days regarding the appeal.</p> | <p>5. Drugostepeno veće Privrednog suda odlučuje o žalbi u roku od sedam (7) dana.</p> |
| <p>6. Kundër Vendimeve të Dhomave të shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, nuk lejohen mjetet e jashtëzakonshme juridike.</p> | <p>6. Extraordinary legal remedies are not allowed against the Decisions of the Chambers of the second instance of the Commercial Court.</p> | <p>6. Protiv odluka drugostepenih veća Privrednog suda nisu dozvoljeni vanredni pravni lekovi.</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 7 Zbatueshmëria e Ligjit për Procedurën kontestimore</p> <p>Dispozitat e Ligjit përkatës të Procedurës Kontestimore janë të zbatueshme edhe për procedurën e falimentimit, për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.</p> | <p style="text-align: center;">Article 7 Implementation of the Law on Contested Procedure</p> <p>Provisions of the Law on Contested Procedure shall be applicable even to the bankruptcy proceeding, as long as they are not in contradiction with the provisions of this Law.</p> | <p style="text-align: center;">Član 7. Primena Zakona o parničnom postupku</p> <p>Odredbe Zakona o parničnom postupku primenjuju se i na stečajni postupak, sve dok nisu u suprotnosti sa odredbama ovog zakona.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 8 Administrimi i rastit</p> <p>1. Gjykata fillon me administrimin e rastit të falimentimit përmes seancave dëgjimore, të cilat fillojnë të zhvillohen jo më larg se shtatë (7) ditë nga dita e pranimit të njoftimit nga palët.</p> <p>2. Gjykata thërret seancën dëgjimore kur një palë kërkon që gjykata të marr një aktvendim ose kur një seancë e tillë dëgjimore është e rëndësishme për administrimin e rastit.</p> <p>3. Nëse një palë pranon një ftesë për seancë dëgjimore nga gjykata dhe nuk e konteston mbajtjen e seancës dëgjimore, kërkesën për masë lehtësuese, ose nuk paraqitet në seancë dëgjimore, konsiderohet se ajo palë është</p> | <p style="text-align: center;">Article 8 Administration of Case</p> <p>1.The court shall conduct the administration of the case through hearings, which shall be conducted on no more than seven (7) days from the day of the receipt of notice by the parties.</p> <p>2.The court shall conduct a hearing when a party requests a decision, or when it is necessary for the administration of the case.</p> <p>3.If a party receives notice of a hearing, and does not object to the hearing or to the relief requested by a party, or does not appear at any hearing, that party shall be deemed to have consented to the relief</p> | <p style="text-align: center;">Član 8. Upravljanje predmetom</p> <p>1.Upravljanje stečajnim predmetom sud počinje putem saslušanja koja počinju najdalje sedam (7) dana od dana prijema obaveštenja od strana.</p> <p>2.Sud saziva raspravu na zahtev jedne strane koja traži od suda donošenje odluke ili kada je saslušanje važno za upravljanje predmetom.</p> <p>3.Ukoliko jedna strana dobije poziv za raspravu i ne ospori održavanje rasprave, zahtev za olakšavajuću meru ili se ne pojavi na saslušanju, smatra se da je ta stranka saglasna sa zahtevom za</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>pajtuar me kërkesën për masë lehtësuese të cilën gjykata e ka paraqitur qartazi në ftesën e dërguar asaj pale për seancë dëgjimore.</p> | <p>requested to the extent that the notice of the hearing includes notice of the type of relief requested.</p> | <p>olakšavajućom merom, koju je sud jasno predstavio u zahtevu koji je dostavio strani za saslušanje.</p> |
| <p style="text-align: center;">KAPITULLI II</p> <p style="text-align: center;">PROCEDURAT E PËRSHPEJTUARA PËR LEHTËSIRAT NDAJ NDËRMARRJEVE TE VOGLA DHE TË MESME (NVM) DHE PËR PLANET E PARA-DAKORDUARA</p> | <p style="text-align: center;">CHAPTER II</p> <p style="text-align: center;">EXPEDITED PROCEEDINGS FOR FACILITIES TO SMALL AND MEDIUM ENTERPRISES (SME) AND FOR PRE-AGREED PLANS</p> | <p style="text-align: center;">POGLAVLJE II</p> <p style="text-align: center;">UBRZANI POSTUPCI ZA OLAKŠICE MALIH I SREDNJIH PREDUZEĆA (MSP) I PRETHODNO DOGOVORENIH PLANOVA</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 9</p> <p style="text-align: center;">Procedura për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme</p> | <p style="text-align: center;">Article 9</p> <p style="text-align: center;">Small and Medium Enterprises Procedure</p> | <p style="text-align: center;">Član 9.</p> <p style="text-align: center;">Postupak kod MSP</p> |
| <p>1. Përveç nëse ndryshe parashihet me këtë ligj, në secilin rast kur debitor paraqitet një Ndërmarrjeve te Vogla dhe të Mesme, ai rast do të trajtohet si rast i riorganizimit.</p> <p>2. Në secilin rast të Ndërmarrjeve te Vogla dhe të Mesme, duhet të paraqes planin e riorganizimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e inicimit të procedurës së falimentimit.</p> <p>3. Nëse debitori është një person fizik Ndërmarrjeve te Vogla dhe të Mesme, atëherë vetëm debitori mund të paraqes planin e</p> | <p>1.A case involving Small and Medium Enterprises debtor shall, unless specified in this Law to the contrary, be treated in all respects as a reorganization case.</p> <p>2.In each Small and Medium Enterprises case, the SME should file a reorganization plan within thirty (30) days from the day of initiation of bankruptcy proceeding.</p> <p>3.If the debtor is an individual, then only the debtor may file the reorganization plan. If the debtor in a SME case is a legal</p> | <p>1.U svakom predmetu kada se kao dužnik pojavi MSP, osim ako ovim zakonom nije drugačije predviđeno, tretira se kao predmet reorganizacije.</p> <p>2.U svakom predmetu MSP mora da podnese plan u roku od trideset (30) dana od dana pokretanja stečajne procedure.</p> <p>3.Ukoliko je dužnik MSP fizičko lice, onda samo dužnik može podneti plan reorganizacije. Ukoliko je dužnik MSP</p> |

| | | |
|---|--|---|
| <p>riorganizimit. Nëse debitori është një person juridik Ndërmarrjeve te Vogla dhe të Mesme, vetëm debitori mund të paraqes një plan të riorganizimit në 30 ditët e para pas inicimit të procedurës së falimentimit.</p> <p>4. Nëse në rastin në të cilin përfshihet debitori Ndërmarrjeve te Vogla dhe të Mesme nuk konfirmohet plani i riorganizimit brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e inicimit të procedurës falimentimit, gjykata do të pushojë rastin pas kërkesës së një pale të interesuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Monitoruesi</p> <p>1.Në secilin rast ku përfshihet një Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme në cilësi të debitorit falimentues, gjykata emëron një monitorues.</p> <p>2. Gjykata zgjedh monitoruesin nga radhët e administratorëve falimentues të licencuar në përputhje me këtë ligj.</p> <p>3.Monitoruesi gëzon të drejtën e kompensimit nga pasuria e falimentimit të debitorit në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Ligji. Tarifat për monitoruesin, metoda e</p> | <p>person, then only the debtor may file a plan for the first thirty (30) days after the initiation of bankruptcy proceeding.</p> <p>4. If a SME debtor’s case does not produce a confirmed plan within sixty (60) of the opening of the case, the court shall dismiss the case upon the request of a party in interest.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Monitor</p> <p>1.In each case when an SME is a bankruptcy debtor, the court shall appoint a monitor.</p> <p>2. The court may select the monitors from any eligible panel or licensed of Administrators in accordance with this law.</p> <p>3.The monitor enjoys the right to compensation from the debtor's bankruptcy estate in accordance with the relevant provisions of this Law. The fees for the</p> | <p>pravno lice, onda samo dužnik može podneti plan reorganizacije u prvih trideset (30) dana nakon pokretanje procedure za stečaj.</p> <p>4. Ukoliko se u predmetu u kome je dužnik MSP u roku od šezdeset (60) dana od pokretanja procedure stečaja ne potvrdi plan reorganizacije, na zahtev zainteresovane stranke sud odbacuje predmet.</p> <p style="text-align: center;">Član 10. Nadzornik</p> <p>1.U svakom predmetu gde je MSP stečajni dužnik, sud imenuje nadzornika.</p> <p>2. Sud bira nadzornika iz redova stečajnih upravnika koji su naimenovani u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>3. Nadzornik ima pravo na naknadu iz stečajne mase dužnika u skladu sa odgovarajućim odredbama ovog zakona. Naknade za nadzornik, način obračuna i</p> |
|---|--|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>Ilogaritjes dhe shuma e tarifave që ndërlidhen me procedurën e falimentimit rregullohen me akt nënligjor të nxjerrur nga Ministri i Drejtësisë.</p> | <p>monitor, the method of calculation and the amount of fees related to the bankruptcy procedure are regulated by a by-law issued by the Minister of Justice.</p> | <p>visina naknada u vezi sa stečajnim postupkom uređuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar pravde.</p> |
| <p>4.Pas emërimit, monitoruesi ka në kompetencë dhe përgjegjësi të këshillon debitorin në lidhje me rrjedhën e biznesit, perspektivat e biznesit dhe mundësinë e përgatitjes së një plani të riorganizimit i cili do të jetë i pranueshëm për kreditorët.</p> | <p>4.After appointment, the monitor is responsible to consult with the debtor regarding the debtor’s business, its prospects, and its ability to formulate a plan that creditors will accept.</p> | <p>4.Nakon naimenovanja, nadzornik savetuje dužnika u vezi sa tokom poslovanja, njegovim perspektivama i mogućnošću pripreme plana reorganizacije koji će za poverioce biti prihvatljiv.</p> |
| <p>5.Monitoruesi shqyrton secilin plan të propozuar nga debitori Ndërmarrjeve te Vogla dhe të Mesme me qëllim të vlerësimit se a ofron plani qëndrueshmëri ekonomike dhe a është i realizueshëm. Shqyrtimi i planit mund të ndodh para ose pasi që debitori ia paraqet planin gjykatës.</p> | <p>5.A monitor shall review each plan a SME debtor files to determine whether it proposes an economically feasible plan. The review may occur before or after the debtor files the plan with the court.</p> | <p>5.Nadzornik razmatra svaki plan koji dužnik MSP podnese kako bi utvrdio da li predloženi plan pruža ekonomsku stabilnost i da li je izvodljiv. Plan se može razmatrati pre ili nakon što ga dužnik podnese sudu.</p> |
| <p>6.Nëse debitori planifikon të kërkoj votimin e kreditorëve në lidhje me planin e paraqitur gjykatës, monitoruesi është i obliguar që brenda dhjetë (10) ditëve t’i paraqesë gjykatës raportin që përfshinë opinionin e tij mbi realizueshmërinë e planit.</p> | <p>6.If the debtor intends to solicit votes on any plan, it shall inform the monitor of that decision, and the monitor shall then have ten (10) days in which it may file with the court a report containing the monitor’s opinion on the feasibility of the plan.</p> | <p>6.Ukoliko dužnik namerava da traži glasanje o planu koji je dostavio sudu, nadzornik je dužan da u roku od deset (10) dana sudu podnese izveštaj sa mišljenjem o izvodljivosti plana.</p> |
| <p>7. Nëse monitoruesi nuk e dorëzon raportin sipas paragrafit 6 të këtij neni, gjykata konsideron se monitoruesi është pajtuar me</p> | <p>7.If a monitor does not file a report according to paragraph 6 of this Article, the court shall consider that the monitor</p> | <p>7.Ukoliko nadzornik ne podnese izveštaj u skladu sa stavom 6 ovog člana, sud zaključuje da se on složio sa planom.</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>planin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Lehtësirat për Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme</p> <p>1. Një debitor Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme mund të marrë konfirmimin për planin e tij të riorganizimit pa i plotësuar të gjitha kërkesat e specifikuar në kapitullin VI të këtij ligji, nëse Gjykata konstaton se këto kushte si në vijim janë përmbushur:</p> <p>1.1. brenda dhjetë (10) ditëve nga inicimi i procedurës së falimentimit, i deponon gjykatës kërkesën me shkrim për zbatim të Kapitullit II të këtij ligji;</p> <p>1.2. monitoruesi i emëruar sipas këtij Kapitulli ka paraqitur në gjykatë raportin mbi realizueshmërinë e planit dhe raporti i është dorëzuar të gjitha palëve të interesuara para fillimit të procedurës së votimit;</p> <p>1.3. i është dorëzuar të gjitha klasave të kreditorëve të prekur nga plani për votim dhe se plani është miratuar nga:</p> | <p>has agreed for the plan.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Small and Medium Enterprises Relief</p> <p>1. An SME debtor may confirm a plan without meeting all the requirements of Chapter VI of this law if the court finds each of these conditions are satisfied:</p> <p>1.1. within ten (10) days from the initiation of bankruptcy proceeding, it files at the court a written request for the implementation of Chapter II of this Law;</p> <p>1.2. the monitor appointed under this Chapter has filed at the court a report on the feasibility of the plan and the report has been delivered to all parties in interest before the commencement of voting procedure;</p> <p>1.3. it has been delivered to all classes of creditors affected by the plan for voting, and that the plan has been approved by:</p> | <p style="text-align: center;">Član 11. Olakšice za MSP</p> <p>1. Dužnik MSP može dobiti potvrdu o njegovom planu reorganizacije bez da ispuni uslove iz poglavlje VI ovog zakona, ukoliko sud zaključi da su svi uslovi ispunjeni:</p> <p>1.1.ukoliko on podnose sudu pisani zahtev za sprovođenje poglavlja II ovog zakona u roku od deset (10) dana od pokretanja stečajnog postupka;</p> <p>1.2.ukoliko je posmatrač, koji je imenovan shodno ovom poglavlju, podneo sudu izveštaj o izvodljivosti plana koji je dostavljen svim zainteresovanim stranama pre glasanja;</p> <p>1.3.ukoliko je dostavljen svim klasama poveriocima koje dotiče plan na glasanja, a plan usvaja:</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>1.3.1. kreditorët që mbajnë të paktën shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të kërkesave të siguruara brenda secilës klasë të kreditorëve të siguar; dhe</p> <p>1.3.2. kreditorët që mbajnë të paktën 33.33% të kërkesave të pasiguruara brenda çdo klase të kreditorëve të pasiguar;</p> <p>1.4. gjykata nxjerr konkluzion se plani i riorganizimit është i realizueshëm kur:</p> <p>1.4.1. monitoruesi nuk e ka dorëzuar raportin, atëherë aplikohet neni 10 i këtij Ligji; ose</p> <p>1.4.2. të paktën 50% i të gjithë kreditorëve të pasiguar të cilët votojnë për planin e pranojnë atë;</p> <p>1.4.3. të gjithë kreditorët e siguar të cilët votojnë për riorganizim e aprovojnë atë;</p> <p>1.4.4. në të gjitha rastet tjera, debitori</p> | <p>1.3.1. creditors holding at least seventy-five percent (75%) of secured claims within each secured creditors class; and</p> <p>1.3.2. creditors holding at least 33.33% of unsecured claims within each unsecured creditors class;</p> <p>1.4. The court concludes the plan is feasible when:</p> <p>1.4.1. if the monitor has not submitted a report, then Article 10 of this Law applies;</p> <p>1.4.2. at least fifty percent (50%) of all unsecured creditors voting on the plan accept the plan;</p> <p>1.4.3. or when all secured creditors who vote for reorganization approve the plan.;</p> <p>1.4.4. in all other cases, the debtor</p> | <p>1.3.1. poverioci koji imaju najmanje sedamdeset pet posto (75)% obezbeđenih potraživanja unutar svake klase obezbeđenih poverilaca; i</p> <p>1.3.2. poverioci koji poseduju najmanje (33,33)% svih neobezbeđenih potraživanja unutar svake klase neobezbeđenih poverilaca.</p> <p>1.4. Sud zaključuje da je plan izvodljiv kada:</p> <p>1.4.1. ukoliko nadzornik nije predao izveštaj, onda se primenjuje član 10 ovog zakona; ili</p> <p>1.4.2. najmanje pedeset posto (50)% svih neobezbeđenih poverilaca glasaju o planu i prihvataju ga;</p> <p>1.4.3. ili kada svi obezbeđeni poverioci glasaju za reorganizaciju i prihvataju plan.</p> <p>1.4.4. u svim dugim slučajevima,</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>duhet të provojë se plani është i realizueshëm;</p> <p>1.5. debitori ofron prova se plani do t'i paguajë të gjithë kreditorët e prekur jo më pak se sa do të realizonin ata në rast se debitori do të paraqiste kërkesë për likuidim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Lirimi për Ndërmarrjeve te Vogla dhe të Mesme</p> <p>Debitori Ndërmarrjeve te Vogla dhe të Mesme lirohet pas konfirmimit të planit të riorganizimit. Lirimi sipas këtij neni do të ketë efektet e njëjta ndaj kërkesave të kreditorëve ndaj Ndërmarrjeve te Vogla dhe të Mesme sikurse lirimi sipas kapitullit VI të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Definimi i planit të para-dakorduar</p> <p>Debitori mund t'i kërkojë kreditorëve të tij lehtësira para fillimi të procedurës së falimentimit. Nëse informatat që i janë dhënë kreditorëve janë të hartuara në përputhje me kërkesat për zbulim të</p> | <p>must prove that the plan is feasible.</p> <p>1.5. the debtor proves that the plan will pay all impaired creditors no less than they would have received had the debtor filed a liquidation case.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Small and Medium Enterprises Discharge</p> <p>A SME debtor shall receive a discharge upon confirmation of its plan. A discharge under this Article shall have the same effect on claims against the SME debtor as would a discharge under Chapter VI of this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Pre-Agreed Plan Definition</p> <p>A debtor may solicit its creditors for debt relief before commencement of bankruptcy proceedings. If the information given creditors in any such solicitation would have complied with the disclosure</p> | <p>dužnik mora dokazati da je plan izvodljiv;</p> <p>1.5. dužnik pruža dokaze o tome da će plan isplatiti sve oštećene poverioce, ne manje od onoga što bi oni ostvarili da je on podneo zahtev za stečaj.</p> <p style="text-align: center;">Član 12. Oslobađanje MSP-a</p> <p>Po potvrđivanju njegovog plana za reorganizaciju, dužnik MSP se oslobađa. Oslobađanje po ovom članu imaće isto dejstvo na potraživanja prema dužniku MSP kao oslobađanje po Poglavlju VI ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 13. Definicija prethodno dogovorenog plana</p> <p>Dužnik može tražiti od svojih poverioca olakšanja pre započinjanja stečajnog postupka. Ukoliko su informacije koje su date poveriocima u skladu sa uslovima za otkrivanje prema poglavlju VI ovog</p> |
|--|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>Kapitullit VI të këtij Ligji, atëherë debitori mund të kërkojë aprovimin e planit në përputhje me nenin 14 të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Procedura për aprovimin e planit të para-dakorduar</p> <p>1.Një debitor i cili ka siguruar votat e kreditorëve të tij për një plan të riorganizimit para paraqitjes së kërkesës për falimentim, mundet sipas zgjedhjes së tij të kërkojë menjëherë nga gjykata konfirmimin e planit në seancë dëgjimore. Kërkesa për konfirmim të planit bëhet menjëherë me kërkesë për fillim të procedurës së falimentimit.</p> <p>2. Nëse debitori paraqet një kërkesë të tillë, gjykata do të mbajë një seancë dëgjimore të shpejtuar në të cilën do të përcaktojë nëse në fazën para fillimit të procedurës, debitori i ka plotësuar kushtet e votimit si dhe kërkesat për zbulim të informatave sipas Kapitullit VI të këtij Ligji.</p> <p>3. Nëse gjykata përcakton se gjatë procedurës para inicimit të rastit të falimentimit, debitori i ka dhënë informacionin e kërkuar kreditorëve sipas Kapitullit VI të këtij Ligji</p> | <p>requirements of Chapter VI of this Law then that debtor may use the provisions of Article 14 of this Law to confirm its plan.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Procedure for Approval of Pre-Agreed Plan</p> <p>1. A debtor which has provided the votes of its creditors on a plan of reorganization before the filing of the bankruptcy claim may, at its choice, immediately request from the court the confirmation of the plan in hearing session. The request for confirmation of the plan shall be done immediately with the request on commencement of bankruptcy proceeding.</p> <p>2. If a debtor makes such a request, the court shall hold an expedited hearing at which it shall determine whether the debtor's pre-filing solicitation of votes was accompanied by disclosure of information that would have been required by Chapter VI of this Law.</p> <p>3. If the court determines that during the procedure before the initiation of the bankruptcy case, the debtor have given the required information to the creditors</p> | <p>zakona, onda dužnik može da traži usvajanje plana u skladu sa članom 14 ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 14. Procedura za usvajanje unapred dogovorenog plana</p> <p>1.Dužnik koji je obezbedio glasove svojih poverilaca za plan reorganizacije pre podnošenja zahteva za stečajni postupak, može po svom izboru, odmah zahtevati od suda potvrđivanje plana na saslušanju. Zahtev za potvrđivanje plana podnosi se odmah zahtevom za pokretanje stečajnog postupka.</p> <p>2.Ukoliko dužnik podnese takav zahtev, sud će održati ubrzanu raspravu na kojoj će utvrditi da li je u fazi pre početka procesa dužnik ispunio uslove glasanja kao i zahteve za otkrivanje informacija u skladu sa poglavljem VI ovog zakona.</p> <p>3.Ukoliko sud utvrdi da je u toku procesa, pre započinjanja stečajnog predmeta, dužnik dostavio poveriocima traženu informaciju, prema poglavlju VI ovog</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>dhe kushtet janë plotësuar, gjykata menjëherë do të vazhdojë me konfirmimin e planit nëse vërtetohet se janë plotësuar kushtet për konfirmim të planit sipas Kapitullit VI të këtij Ligji.</p> | <p>according to Chapter VI of this Law, and the conditions are fulfilled, the court shall immediately proceed with the confirmation of the plan if there is determined that the conditions on the confirmation of the plan according to Chapter VI of this Law have been fulfilled.</p> | <p>zakona i da su ispunjeni uslovi, sud odmah nastavlja sa potvrđivanjem plana, ukoliko se potvrdi da su ispunjeni uslovi za potvrđivanje plana u skladu sa poglavljem VI ovog zakona.</p> |
| <p>4. Nëse gjykata vërteton se gjatë procedurës para inicimit të rastit të falimentimit, debitori nuk i ka dhënë informatat e kërkuara sipas Kapitullit VI të këtij Ligji, atëherë gjykata nxjerr aktvendim për refuzimin e konfirmimit të planit të riorganizimit dhe debitori vazhdon me procedurën e falimentimit sikurse të mos kishte ekzistuar fare plani i para-dakorduar.</p> | <p>4. If the court determines that during the procedure before the initiation of the bankruptcy case, the debtor has not given the information required by Chapter VI of this Law, the court shall issue the ruling on denying the confirmation of the reorganization plan and the debtor shall proceed with its bankruptcy proceeding as there would not have existed at all the pre-agreed plan.</p> | <p>4.Ukoliko sud utvrdi da u toku procesa, pre započinjanja stečajnog predmeta, dužnik nije dostavio poveriocima tražene informacije, prema poglavlju VI ovog zakona, onda sud donosi odluku o odbijanju potvrđivanja plana za reorganizaciju, a dužnik nastavlja sa procesom stečaja kao da unapred dogovoreni plan nije postojao.</p> |
| <p>5. Kundër aktvendimit sipas paragrafit 4 të këtij neni për refuzimin e konfirmimit të planit të riorganizimit, nuk lejohet ankesë.</p> | <p>5.No appeal is allowed against the decision according to paragraph 4 of this article for the denial to confirm the reorganization plan.</p> | <p>5.Protiv odluke iz stava 4. ovog člana o odbijanju potvrđivanja plana reorganizacije nije dozvoljena žalba.</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p style="text-align: center;">KAPITULLI III</p> <p style="text-align: center;">INICIMI I PROCEDURËS DHE HAPJA E RASTIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Hapja e rastit</p> <p>1. Një rast për riorganizim ose likuidim sipas këtij Ligji, konsiderohet se është hapur kur:</p> <p>1.1. Debitori në gjykatë paraqet një kërkesë për inicim vullnetar të riorganizimit ose likuidimit; ose</p> <p>1.2. është paraqitur një kërkesë jo-vullnetare kundër debitorit, gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore për kërkesën e paraqitur dhe gjykata ka nxjerr aktvendim për pranueshmerinë e kërkesës dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Inicimi vullnetar i falimentimit nga debitori</p> <p>1. Për inicim vullnetar të rastit, debitori në gjykatë paraqet kërkesën për riorganizim ose</p> | <p style="text-align: center;">CHAPTER III</p> <p style="text-align: center;">INITIATION OF THE PROCEDURE AND OPENING OF A CASE</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Opening of a Case</p> <p>1. A case for reorganization or liquidation under this Law is considered opened when:</p> <p>1.1. the debtor files a voluntary petition for either liquidation or reorganization; or</p> <p>1.2. an involuntary petition is filed against the debtor and, after a hearing on notice to the debtor; the court shall issue a ruling finding that the petition meets all of the requirements of this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Voluntary Cases Opened by a Debtor</p> <p>1. For voluntary initiation of a case, a debtor files either a petition in</p> | <p style="text-align: center;">POGLAVLJE III</p> <p style="text-align: center;">POKRETANJE PROCEDURE I OTVARANJE PREDMETA</p> <p style="text-align: center;">Član 15. Otvaranje predmeta</p> <p>1. Predmet se smatra otvorenim kada:</p> <p>1.1. dužnik podnese dobrovoljni zahtev za pokretanje reorganizacije ili likvidacije;</p> <p>1.2. je podnet ne dobrovoljni zahtev protiv dužnika, sud je održao saslušanje vezano za podneti zahtev i doneo odluku o prihvatanju zahteva i ispunjenju uslova koji su određeni ovim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 16. Dobrovoljno pokretanje predmeta od samog dužnika</p> <p>1. Za dobrovoljno pokretanje predmeta, dužnik podnosi zahtev za reorganizaciju</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|--|--|
| <p>kërkesë për likuidim.</p> <p>2. Debitori nuk duhet të jetë në situatë të paaftësisë paguese për tu kualifikuar për të qenë debitor sipas këtij ligji.</p> <p>3. Nëse debitori paraqet një kërkesë për qëllime të papërshtatshme ose me qëllim të mashtrimit ose shkaktimit të dëmit ndaj kreditorëve, gjykata mund ti shqiptojë gjobë debitorit ose anëtarëve individual të trupave menaxhues ose qeverisës së debitorit.</p> <p>4. Konsiderohet se debitori ka paraqitur një kërkesë për qëllime të papërshtatshme ose me qëllim të mashtrimit ose shkaktimit të dëmit ndaj kreditorëve sipas paragrafit (3) të këtij neni, nëse debitori:</p> <p>4.1. paraqet kërkesë pa e dhënë emrin e tij të saktë; ose</p> <p>4.2. nuk i liston të gjithë emrat e mëparshëm përmes të cilave ka qenë i përfshirë në afarizëm; ose</p> <p>4.3. nuk e liston një kreditor dhe si rezultat ai kreditor nuk pranon njoftim për inicim të procedurës; ose</p> | <p>reorganization or a petition in liquidation.</p> <p>2. A debtor does not need to be insolvent to be eligible to be a debtor under this law.</p> <p>3. If a debtor files a petition for an improper purpose or in a manner intended to deceive, defraud or subvert the creditors, the court may fine the debtor or individual members of the debtor's management or governing body.</p> <p>4. It is considered that a debtor has filed its petition for an improper purpose or with the intent to deceive or cause damage to creditors according to paragraph 3 of this Article, if a debtor:</p> <p>4.1. files a case without listing its name properly;</p> <p>4.2. does not list all prior material names under which it has conducted business;</p> <p>4.3. does not list a material creditor and that creditor does not therefore receive knowledge of the proceeding; or</p> | <p>ili likvidaciju.</p> <p>2. Nema potrebe da dužnik bude nesolventan da bi se kvalifikovao da bude dužnik po ovom zakonu.</p> <p>3. Ukoliko dužnik podnese zahtev u neprikladne svrhe, u nameri obmane ili u cilju izazivanja štete poveriocima, sud može izreći kaznu dužniku ili pojedinačno članovima upravnih tela ili rukovodstvu dužnika.</p> <p>4. Smatra se da je dužnik podneo zahtev sa neprikladnom namerom, u cilju obmane ili izazivanja štete poveriocima u skladu sa stavom 3 ovog člana, ukoliko dužnik:</p> <p>4.1. podnese zahtev bez tačnog navođenja svog imena; ili</p> <p>4.2. ne navede sve prethodne nazive pod kojima je poslova; ili</p> <p>4.3. ne navede jednog poverioca zbog čega taj poverilac ne prima obaveštenje o pokretanju postupka;</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|--|
| <p>asgjë nga debitori.</p> <p>3.Lidhur me anulimin e transkasionit nga paragrafit 1 të këtij neni, vendos Gjykata me aktvendim.</p> <p>4.Ndaj aktvendimit të Gjykatës sipas paragrafit 3 të këtij neni mund të ushtrohet ankesë në dhomat e shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të aktvendimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36 Marrja e pasurisë</p> <p>1. Përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit ka kompetencë të kthejë përmes veprimit ose të kërkojë dhe pranojë kthimin e cilësdo pronë, pjesë e pasurisë së falimentimit e cila është duke u mbajtur nga një person tjetër nga debitori në momentin e fillimit të procedurës së falimentimit.</p> <p>2. Cilido person i cili posedon ose kontrollon një pronë, pjesë të pasurisë së falimentimit duhet t'i dorëzojë përfaqësuesit të pasurisë së falimentimit atë pronë ose kundërvlerën e plotë të asaj prone, sipas zgjedhjes së</p> | <p>3. Regarding the cancellation of the transaction from paragraph 1 of this article, the Court decides with a ruling.</p> <p>4. Regarding the decision of the Court according to paragraph 3 of this article, an appeal can be filed in the chambers of the second instance of the Commercial Court within 7 days from the date of acceptance of the decision.</p> <p style="text-align: center;">Article 36 Turnover</p> <p>1. The bankruptcy estate representative shall have the power to recover by action, or to demand and receive the turnover of, any property of the bankruptcy estate held as of the opening of the case by an entity other than the debtor.</p> <p>2. Any person in possession or control of property of the bankruptcy estate shall deliver to the bankruptcy estate representative, and account for, such property or the value of such property, subject to the representative of the estate providing protection of value.</p> | <p>3.O otkazivanju transakcije iz stava 1. ovog člana sud odlučuje rešenjem.</p> <p>4.Na odluku suda iz stava 3. ovog člana može se uložiti žalba drugostepenom veću Privrednog suda u roku od 7 dana od dana prijema odluke.</p> <p style="text-align: center;">Član 36. Povraćaj imovine</p> <p>1.Zastupnik stečajne mase ima ovlašćenja da tužbom povrati ili da traži i primi promet bilo koje aktive iz stečajne mase koju, u trenutku otvaranja stečajnog postupka, drži drugi subjekat a ne dužnik.</p> <p>2.Svako lice koje ima ili kontroliše imovinu stečajne mase treba da preda zastupniku stečajne mase tu imovinu ili njenu punu protiv vrednost, prema izboru predstavnika imovine.</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>përfaqësuesit të pasurisë falimentuese, me kushtin e mbrojtjes së vlerës nga përfaqësuesi i pasurisë.</p> <p>3. Cilido person i cili ka një detyrim që është pronë, pjesë e pasurisë falimentuese dhe ai detyrim është maturuar ose është bërë i pagueshëm, duhet që menjëherë pas kërkesës ta përmbush në tërësi detyrimin të përfaqësuesi i pasurisë falimentuese.</p> <p style="text-align: center;">Neni 37 Preferencat</p> <p>1. Përveç në rastet e parapara në paragrafin 3 të këtij neni, përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit mund të kërkojë sipas nenit 35 të këtij Ligji, anulimin e një transferi, bartje nëse:</p> <p>1.1. bartja ka ndodhur para fillimit të procedurës së falimentimit;</p> <p>1.2. bartja i është bërë kreditorit ose është bërë për përfitim të kreditorit ku pagesa ka pasur efektin e zvogëlimit të ekspozimit ndaj një garancioni për llogari të borxhit i cili është mbledhur para bartjes;</p> | <p>3. An person that owes a debt that is property of the bankruptcy estate and that is matured, payable on demand, or payable on order, shall pay such debt in total to, or to the order of, the bankruptcy estate representative.</p> <p style="text-align: center;">Article 37 Preferences</p> <p>1. Subject to the defenses set forth in paragraph 3 of this Article, the bankruptcy estate representative may request as per Article 35 of this Law, to nullify a transfer to the extent it:</p> <p>1.1. was made before commencement of bankruptcy proceeding;</p> <p>1.2. was made to a creditor or for the benefit of a creditor such as payment that had the effect of reducing the exposure on a guaranty on account of a debt that was incurred before the transfer;</p> <p>1.3. was made while the debtor was insolvent;</p> | <p>3. Svako lice koje ima dugovanje koje je vlasništvo stečajne mase a koje je dospelo, plativo na zahtev ili plativo po nalogu, mora da plati to dugovanje u celosti zastupniku stečajne mase, samostalno ili na njegov zahtev.</p> <p style="text-align: center;">Član 37. Preference</p> <p>1. Pod uslovima iz prigovora iz stava 3. ovog člana, zastupnik stečajne mase može zatražiti shodno članu 35. ovog zakona da se izbegne neki transfer, u meri u kojoj je:</p> <p>1.1. izvršen pre započinjanja stečajnog postupka;</p> <p>1.2. izvršen poveriocu ili u korist poverioca gde je isplata uticala na smanjenje izloženosti garancije na račun duga koji je nastao pre transfera;</p> <p>1.3. transfer izvršen dok je dužnik bio nesolventan;</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|---|---|
| <p>1.3. bartja është bërë kur debitori ka qenë josolvent;</p> <p>1.4. bartja është bërë deri në njëqind e njëzet (120) ditë para inicimit të procedurës së falimentimit, ndërsa në rastet kur përfituesi i transferit është person i brendshëm bartja është bërë deri treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë para inicimit të procedurës së falimentimit; dhe</p> <p>1.5. bartja i ka mundësuar përfituesit të transferit të pranojë më shumë nga debitori dhe pasuria e falimentimit, se sa që do të kishte pranuar në rastet kur të iniciohej procedura e likuidimit dhe ai do të kishte marrë pjesën e tij nga pasuria e likuiduar.</p> <p>2. Bartja nuk kualifikohet sipas paragrafit 1 nën-paragrafit 1.5 të këtij neni, nëse bartja i është bërë:</p> <p>2.1. një kreditori të siguruar gjatë kohës kur vlera e kolateralit të kreditorit ka qenë më e madhe se shuma e kërkesës se siguruar të kreditorit;</p> <p>2.2. një kreditori me kërkesë të siguruar,</p> | <p>1.4. was made within one hundred and twenty (120) days of the commencement of bankruptcy proceeding, however, that if the transferee was an insider, it was made within three hundred and sixty-five (365) day period of the commencement of bankruptcy proceeding; and</p> <p>1.5. enabled the transferee to receive more from the debtor and bankruptcy estate that it would have had the transfer not been made and the transferee had received only a dividend in a liquidation case.</p> <p>2. The transfer shall not be qualified according to paragraph 1 sub-paragraph 1.5 of this Article, if it was made:</p> <p>2.1. to a secured creditor at a time when the value of its collateral was more than the amount of the secured creditor's claim;</p> <p>2.2. to a creditor holding a secured claim whose collateral is worth less than its total claims, but only to the</p> | <p>1.4.transfer je izvršen u toku sto dvadeset (120) dana pre pokretanja stečajnog postupka, u situaciji kada je korisnik transfera unutrašnja osoba, transfer je izvršen do trista šezdeset pet (365) dana pre pokretanja stečajne procedure; i</p> <p>1.5.transfer je omogućio primaocu da dobije više od dužnika i stečajne mase, nego što bi dobio da transfer nije načinjen i da je primalac dobio samo dividend u predmetu likvidacije.</p> <p>2.Transfer se ne kvalifikuje prema stavu 1 podstav 1.5. ovog člana, ukoliko je izvršen:</p> <p>2.1.osiguranom poveriocu u vreme kada je vrednost kolaterala poverioca bila veća od osiguranog iznosa;</p> <p>2.2.poveriocu osiguranog zahteva, čiji kolateral vredi manje nego njegova ukupna potraživanja ali samo u meri u</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>kolaterali i të cilit ka vlerë më të vogël se të gjitha kërkesat e tij, por vetëm deri në masën që vlera e bartjes tejkalon vlerën e diferencës në mes të vlerës së të gjitha kërkesave të kreditorit dhe vlerës së kolateralit të kreditorit; dhe</p> <p>2.3. një kreditori me prioritet në pagesa ndaj kreditorëve të pasiguar, përderisa pasuria e falimentimit nuk është në situatë të pa-aftësisë paguese të shpenzimeve administrative.</p> <p>3. Përfituesi gëzon mbrojtje të plotë ndaj një veprimi për anulim të bartjes sipas paragrafit 1 të këtij neni, përderisa:</p> <p>3.1. bartja është si rezultat i rrjedhës normale të biznesit të debitorit;</p> <p>3.2. bartja është barrë dhe barra është dhënë për t'i mundësuar debitorit blerjen e pronës të ngarkuar me atë barrë; ose</p> <p>3.3. bartja është bërë si rezultat i urdhrorit të gjykatës për pagesë të alimentacionit ose kompenzimit të viktimave të dhunës.</p> | <p>extent that the amount of the transfer exceeded the value of the difference between the creditor's total claims and the value of the creditor's collateral; and</p> <p>2.3. to a creditor with priority of payment over general unsecured creditors to the extent that the estate is not administratively insolvent.</p> <p>3. A beneficiary has a complete defense to an action seeking to avoid a transfer under paragraph 1 of this Article to the extent that:</p> <p>3.1. the transfer was made in the debtor's ordinary course of business;</p> <p>3.2. the transfer was a lien, and lien was given to enable the debtor to acquire the property subject to the lien; or</p> <p>3.3. the transfer was in the nature of court-ordered for payment of alimony or crime victim compensation.</p> <p>3.4. The transfer was made as a result of a final Executive Order or a final</p> | <p>kojoj suma transfera prevazilazi vrednost razlike između ukupnih potraživanja poverioca i vrednosti kolaterala; i</p> <p>2.3.poveriocu sa prioritetoem plaćanja prema osiguranim poveriocima, dok stečajna masa nije u stanju nesposobnosti plaćanja administrativnih troškova.</p> <p>3.Korisnik ima kompletnu zaštitu od aktivnosti za otkazivanje transfera po stavu 1ovog člana u meri u kojoj je:</p> <p>3.1.transfer rezultat normalnog toka poslovanja dužnika;</p> <p>3.2.transfer zalog koji je dat da bi dužniku omogućio kupovinu imovine koja je opterećena tim zalogom; ili</p> <p>3.3.transfer izvršen po nalogu suda za isplatu alimentacije ili nadoknade žrtava nasilja.</p> <p>3.4. Prenos je izvršen kao rezultat pravosnažnog izvršnog naloga ili</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|---|--|
| <p>3.4. Bartja është bërë si rezultat i Urdhrit të plotfuqishëm Përmbarrimor apo vendimit të plotfuqishëm të Gjykatës, në të cilën procedurë përfituesi ishte kreditor që e kishte bartur pasurinë në emrin e vet sipas Ligjit të Procedurës Përmbarrimore.</p> <p>4. Për qëllime të këtij neni:</p> <p>4.1. debitori konsiderohet se ka qenë në pa-aftësi paguese gjatë njëqind e njëzet (120) ditëve para inicimit të procedurës së falimentimit;</p> <p>4.2. përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit duhet të provojë ekzistimin e të gjithë elementeve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>5. Përfituesi duhet të provojë të drejtën e tij për të gëzuar mbrojtje sipas paragrafit 3 të këtij neni me qëllim të gëzimit të asaj mbrojtje.</p> <p style="text-align: center;">Neni 38 Bartjet jo komerciale dhe për qëllime mashtrimi</p> | <p>Court decision, in which procedure the beneficiary was a creditor who had transferred the property in his own name according to the Law of Enforcement Procedure.</p> <p>4. For purposes of this Article:</p> <p>4.1. the debtor shall be presumed to be insolvent during the one hundred and twenty (120) day period before the commencement of bankruptcy proceeding; and</p> <p>4.2. the bankruptcy estate representative must prove the existence of all of the elements of paragraph 1 of this Article.</p> <p>5. The beneficiary must prove the entitlement to a defense under paragraph 3 of this Article in order to establish its defense.</p> <p style="text-align: center;">Article 38 Fraudulent or uncommercial transfers</p> <p>1.The bankruptcy estate representative may request from the Court to nullify a</p> | <p>pravosnažne sudske odluke, u kom postupku je korist imao poverilac koji je prenio imovinu na svoje ime u skladu sa Zakonom o izvršnom postupku.</p> <p>4.Za potrebe ovog člana:</p> <p>4.1.dužnik se smatra nesolventnim tokom perioda od sto dvadeset (120) dana pre započinjanja stečajnog postupka; i</p> <p>4.2.zastupnik stečajne mase mora dokazati postojanje svih elemenata koji su predviđeni u stavu 1 ovog člana.</p> <p>5.Da bi mogao da uživa pravo na zaštitu, u skladu sa stavom 3 ovog člana, korisnik to pravo mora dokazati.</p> <p style="text-align: center;">Član 38. Prevarni ili nekomercijalni transferi</p> <p>1.Zastupnik stečajne mase može da zatraži od suda da se izbegne</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>1. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese kërkon nga Gjykata anulimin e një bartje jo-komerciale ose një obligim të debitorit në rast se:</p> <p>1.1. bartja është bërë nga debitori me qëllim të fshehjes, pengimit ose mashtrimit të kreditorëve deri 2 vite para inicimit të procedurës së falimentimit;</p> <p>1.2. bartja është bërë me vlerë më të vogël se vlera e arsyeshme kur:</p> <p>1.2.1. debitori ka qenë në situatë të pa aftësisë paguese; ose</p> <p>1.2.2. nuk ka pasur kapital ose rezerva të mjaftueshme për t'i paguar detyrimet e tij të pritshme; dhe</p> <p>1.2.3. është bërë deri 2 vite para inicimit të procedurës së falimentimit.</p> <p>2. Përfituesi i bartjes ose përfituesi i pagesës së një detyrimi që pranon një vlerë dhe që ka një barrë në mirëbesim mund të ruajë një interes të bartur ose mund të përmbarojë</p> | <p>non-commercial transfer or an obligation of the debtor to the extent that it:</p> <p>1.1. was made by the debtor with the intent to hinder, delay, or defraud creditors within two (2) years from the commencement of bankruptcy proceedings.</p> <p>1.2. was made for less than reasonably equivalent value while the debtor:</p> <p>1.2.1. the debtor was insolvent; or</p> <p>1.2.2. had insufficient capital or reserves to pay reasonably anticipated obligations; and</p> <p>1.2.3. was made within two (2) years of the commencement of the bankruptcy proceeding.</p> <p>2. A transferee of a transfer or an obligee on an obligation that takes for value and in good faith has a lien on or may retain any interest transferred or may enforce any obligation incurred, as the case may be, to the extent that such transferee or obligee</p> | <p>nekomercijalni transfer ili obaveza dužnika, u meri u kojoj je:</p> <p>1.1.izvršen od dužnika sa namerom prikrivanja, ometanja ili prevare poverilaca do dve (2) godine pre pokretanja stečajnog postupka;</p> <p>1.2.izvršen u vrednosti manjoj od razumne vrednosti ukoliko:</p> <p>1.2.1.je dužnik bio nesolventan; ili</p> <p>1.2.2.dužnik nije raspolagao dovoljnim kapitalom ili rezervom za plaćanje svojih očekivanih obaveza; i</p> <p>1.2.3.je izvršen do dve (2) godine pre pokretanja stečajnog postupka.</p> <p>2.Korisnik transfera ili plaćanja obaveze koji primi vrednost i koji ima pouzdani zalog može zadržati preneti interes ili bilo kakvu nastalu obavezu, do mere u kojoj takav prenos ili isplata daje vrednost dužniku u zamenu za transfer ili obavezu.</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|--|---|
| <p>çfarëdo obligimi të mbledhur, deri në masën që një bartje ose pagesë e tillë i jep vlerë debitorit në shkëmbim për bartjen ose detyrimin.</p> <p>3. Për qëllime të këtij neni, “vlerë” nënkupton pronën, përmbushjen ose sigurimin e një borxhi të tanishëm ose të ardhshëm të debitorit, por nuk përfshinë premtimin e papërmbushur për dhënie të mbështetjes debitorit ose një të afërmi të debitorit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 39 Kërkesat e siguruara me hipotekat jo të plota ose të papërshtatshme</p> <p>1. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të anulojë një barrë nëse:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. një ligj i aplikueshëm kërkon regjistrimin e një barre në regjistra publik; dhe</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. kreditori deri në momentin e inicimit të procedurës së falimentimit nuk e ka kryer obligimin ligjor të regjistrimit të barrës së tillë në regjistra publik.</p> | <p>gave value to the debtor in exchange for such transfer or obligation.</p> <p>3. For purposes of this Article, “value” means property, or satisfaction or securing of a present or antecedent debt of the debtor, but does not include an unperformed promise to furnish support to the debtor or to a close relative of the debtor;</p> <p style="text-align: center;">Article 39 Improper or Incomplete Security Interests or Mortgages</p> <p>1. The bankruptcy estate representative may avoid any creditor’s lien if:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. an applicable law requires the registration of the lien in any public registry; and</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. the creditor had not, as of the commencement of bankruptcy proceeding, taken all steps necessary to provide such notice.</p> <p style="text-align: center;">Article 40 Status of Execution Creditor</p> | <p>3.U svrhu ovog člana, “vrednost” znači imovina, zadovoljenje ili osiguranje postojećeg ili budućeg duga dužnika ali ne obuhvata neispunjeno obećanje za pružanje podrške dužniku ili nekom njegovom srodniku.</p> <p style="text-align: center;">Član 39. Nepravilni ili nepotpuni obezbeđeni interesi ili hipoteke</p> <p>1.Zastupnik stečajne mase može ukinuti zalog bilo kog poverioca ukoliko:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1.važeći zakon traži registraciju zaloga u javnom registru; i</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2.poverilac do pokretanja stečajnog postupka nije izvršio zakonsku obavezu registracije tog zaloga u javnom registru.</p> <p style="text-align: center;">Član 40. Status poverioca izvršitelja</p> |
|---|--|---|

| | | |
|---|---|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 40 Statusi i kreditorit përmbarues</p> <p>Përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit e ka statusin e kreditorit përmbarimor të supozuar nga momenti i inicimit të procedurës së falimentimit, dhe do të ketë prioritetin e supozuar mbi të gjitha barrat ndaj të gjitha kërkesave të të gjithë kreditorëve, në masën e njëjtë që do ta kishte debitori po të mos iniciohej procedura e falimentimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 41 Bartjet e pa-autorizuara pas paraqitjes së kërkesës për falimentim</p> <p>1. Përveç në rastet sipas nënparagrafin 1.2 të këtij neni, përfaqësuesi i pasurisë falimentimit mund të kërkojë anulimin e një bartje të pronës, pjesë të pasurisë së falimentimit:</p> <p>1.1. e cila ka ndodh pas inicimit të procedurës së falimentimit; dhe</p> <p>1.2. e cila nuk është e lejuar sipas këtij ligji ose nga gjykata;</p> | <p>The bankruptcy estate representative shall have the status of a supposed execution creditor from the moment of commencement of the bankruptcy procedure, and shall have the supposed priority with respect to the claims of all creditors to the same extent as the debtor would have if he would not have commenced the bankruptcy proceeding.</p> <p style="text-align: center;">Article 41 Unauthorized Transfers after the Filing of the petition for bankruptcy</p> <p>1. Except as provided in sub-paragraph 1.2 of this Article, the bankruptcy estate representative may request to avoid a transfer of property of the bankruptcy estate:</p> <p>1.1. that occurs after the commencement of bankruptcy proceeding; and</p> <p>1.2. that was not authorized under this Law or by the court;</p> <p>1.3. in a case commenced by creditors, the bankruptcy estate representative</p> | <p>Predstavnik stečene imovine ima status izvršnog pretpostavljenog kreditora, od trenutka iniciranja stečajne procedure, i ima će pretpostavljeni prioritet nad svim teretima i nad svim zahtevima od strane svih kreditora, u istoj meri koju bi imao dužnik kada ne bi bilo inicirano procedura stečaja.</p> <p style="text-align: center;">Član 41. Neovlašćeni transferi nakon podnošenja zahteva za stečaj</p> <p>1. Osim u situacijama iz podstava 1.2. ovog člana, zastupnik stečajne mase može da zatraži da se izbegne neki transfer imovine stečajne mase:</p> <p>1.1. koji je izvršen nakon započinjanja stečajnog postupka; i</p> <p>1.2. koji ovaj zakon ili sud ne dozvoljava;</p> <p>1.3. u situacijama kada stečajnu proceduru pokreću poverioci,</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>1.3. në rastet e inicimit të procedurës së falimentimit nga kreditorët, përfaqësuesi i pasurisë falimentimit nuk mund të anulojë një bartje e cila ka ndodhur pas paraqitjes së kërkesës për inicim të procedurës së falimentimit dhe para hapjes së rastit, përderisa përfituesi i bartjes ka dhënë një vlerë në shkëmbim të bartjes së tillë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 42 Mbrojtjet e përgjithshme</p> <p>1. Përderisa një bartje është anuluar në përputhje me këtë ligj, përfaqësuesi i pasurisë se falimentimit mund të rikthejë pronën e transferuar në pasurinë e falimentimit ose vlerën e asaj prone nëse urdhëron gjykata, nga:</p> <p>1.1. përfituesit fillestar të bartjes së tillë ose prej entitetit i cili ka përfituar nga bartja e tillë; ose</p> <p>1.2. cilitdo përfitues i asaj bartjeje, ose kushdo i cili është përfitues titullar i asaj bartjeje, si rezultat i bartjes nga përfituesi fillestar.</p> <p>2. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese nuk mund të rikthejë pronën sipas nën-paragrafit</p> | <p>may not avoid a transfer made after the commencement of bankruptcy proceeding but before the case is opened to the extent the transferee gave any value in exchange for such transfer.</p> <p style="text-align: center;">Article 42 General Defenses</p> <p>1. To the extent that a transfer is avoided under this law, the bankruptcy estate representative may recover, for the benefit of the estate, the property transferred, or, if the court so orders, the value of such property, from:</p> <p>1.1. the initial transferee of such transfer or the entity for whose benefit such transfer was made; or</p> <p>1.2. any transferee of such initial transferee, or anyone whose title to the property traces to or derives from the transfer to initial transferee.</p> <p>2.The bankruptcy estate representative may not recover under sub-paragraph 1.2 of paragraph 1 of this Article from:</p> | <p>zastupnik stečajne mase ne može ukinuti transfer izvršen nakon podnošenja zahteva za stečajni postupak i pre otvaranja predmeta, dok korisnik transfera ne da jednu sumu u zamenu za taj transfer.</p> <p style="text-align: center;">Član 42. Opšte odbrambene mere</p> <p>1.Sve dok je transfer ukinut u skladu sa ovim zakonom, zastupnik stečajne mase može povratiti prenetu imovinu ili vrednost te imovine, ukoliko sud to naloži:</p> <p>1.1.od početnog korisnika transfera ili subjekta u čiju korist je transfer izvršen; ili</p> <p>1.2.bilo kog korisnika tog transfera ili bilo koga ko je titularni korisnik tog transfera, kao rezultat transfera od početnog korisnika.</p> <p>2.Zastupnik stečajne mase ne može povratiti imovinu prema podstavu 1.2 stava 1 ovog člana od:</p> |
|---|---|--|

| | | |
|--|---|--|
| <p>1.2 të paragrafit 1 të këtij neni, nga:</p> <p>2.1. përfituesi i bartjes i cili e ka pranuar vlerën për të përmbushur një borxh të tashëm ose të ardhshëm të debitorit, në mirëbesim, pa pasur njohuri se një bartje e tillë do të mund të anulohet;</p> <p>2.2. cilido përfitues i bartjes nga përfituesi paraprak i bartjes i cili ka vepruar me mirëbesim.</p> <p>3. Një përfitues i transferit me mirëbesim prej të cilit përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të rikthejë pronën sipas paragrafit 1 të këtij neni, ka të drejtën e kompenzimit të plotë për:</p> <p>3.1. koston për përmirësimet e bëra pas bartjes ndaj përfituesit të transferit, duke zvogëluar profitin e realizuar nga ajo pronë;</p> <p>3.2. çfarëdo rritje të vlerës të asaj prone si rezultat i përmirësimeve të bëra, të pronës së bartur.</p> | <p>2.1. a transferee that takes for value, including satisfaction or securing of a present or antecedent debt, in good faith, and without knowledge that the transfer could be nullified under this Law; or</p> <p>2.2. any good faith transferee of such transferee.</p> <p>3. A good faith transferee from whom the bankruptcy estate representative may recover under paragraph 1 of this Article has a lien on the property recovered to secure the lesser of:</p> <p>3.1. the cost, to such transferee, of any improvement made after the transfer, less the amount of any profit realized by or accruing to such transferee from such property; and</p> <p>3.2. any increase in the value of such property as a result of such improvement, of the property transferred.</p> <p>4. The bankruptcy estate representative is entitled to the compensation of one of the</p> | <p>2.1. primaoca transfera koji je primio vrednost da bi pokrio sadašnji ili budući dug dužnika, u poverenju, bez saznanja da bi taj transfer mogao biti ukinut;</p> <p>2.2. bilo koji primalac prethodnog transfera koji je postupio u poverenju.</p> <p>3. Primalac transfera u poverenju, od koga zastupnik stečajne mase može povratiti imovinu prema stavu 1 ovog člana, ima zalog na imovinu koja je povraćena da bi osigurao:</p> <p>3.1. cenu za izvršene prepravke nakon transfera korisniku, manju od iznosa nekog profita koji je korisnik transfera ostvario od te imovine; i</p> <p>3.2. bilo koje povećanje vrednosti te imovine kao rezultata poboljšanja prenete imovine.</p> <p>4. Zastupnik stečajne mase ima pravo na naknadu jednog od prava predviđenih</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|--|---|
| <p>4. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese ka të drejtë ne kompensimin e njërës nga te drejtat e parapara sipas këtij neni por nuk mund të kërkojë kompensimet e parapara në mënyrë kumulative.</p> <p style="text-align: center;">Neni 43 Shpërblimi i Ekspertëve</p> <p>1. Pas njoftimit të dërguar palëve të interesuara, gjykata urdhëron që një ekspert të punësuar sipas këtij ligji:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. t'i paguhet shpërblimi për shërbimet e ofruara nga eksperti ose nga një person tjetër i punësuar nga eksperti; dhe</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. t'i rimbursohen shpenzimet reale dhe të nevojshme.</p> <p>2. Gjkata sipas kërkesës së palës ose sipas vlerësimit të saj, ti ofroj një shpërblim më të vogël ekspertit se sa shpërblimi që është kërkuar nga ai.</p> <p>3. Gjatë përcaktimit të shumës së shpërblimit për ekspertin, gjykata do të ketë për bazë natyrën e punës, kohëzgjatjen dhe vlerën e</p> | <p>rights foreseen under this article, but I cannot claim the compensations foreseen in a cumulative way.</p> <p style="text-align: center;">Article 43 Compensating Experts</p> <p>1. After notice to the parties in interest the court may award to an expert employed under this Law:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. reasonable compensation for actual, necessary services rendered by the expert, or by any other expert employed by any such person; and</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. reimbursement for actual, necessary expenses.</p> <p>2. The court may, on its own motion or on the motion of any party in interest, award compensation that is less than the amount of compensation requested by the expert.</p> <p>3. In determining the amount of reasonable compensation to be awarded to an expert, the court shall consider the nature, the extent, and the value of such services, taking into account all relevant factors,</p> | <p>ovim članom, ali ne može da traži previdene naknade kumulativno.</p> <p style="text-align: center;">Član 43. Nadoknada za veštake</p> <p>1. Nakon obaveštenja poslatog zainteresovanim strankama, veštaku angažovanom u skladu sa ovim zakonom sud može da dodeli:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. razumnu naknadu za stvarne i neophodne usluge koje je pružio taj veštak ili neki drugi veštak koga je to lice zaposlilo; i</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. nadoknade stvarnih i neophodnih troškova.</p> <p>2. Na zahtev stranke ili prema svojoj oceni sud po sopstvenom nahođenju nudi veštaku manju nadoknadu od one koju je on tražio.</p> <p>3. Pri utvrđivanju sume za nadoknadu veštaku, sud uzima za osnovu prirodu posla, vreme trajanja i vrednost tih usluga, uzimajući u obzir sve relevantne faktore, uključujući:</p> |
|---|--|---|

| | | |
|---|---|--|
| <p>shërbimeve të tilla, duke konsideruar të gjithë faktorët, përfshirë:</p> <p>3.1. kohën e kaluar në ofrimin e atyre shërbimeve;</p> <p>3.2. tarifat e faturuara për ato shërbime;</p> <p>3.3. nëse shërbimet ishin të nevojshme për administrimin ose ishin të dobishme në kohën në të cilën shërbimi ishte kryer drejt përfundimit të një procesi falimentimi;</p> <p>3.4. nëse shërbimet janë kryer për një kohë të arsyeshme, duke pas parasysh komplikueshmerinë, rëndësinë dhe natyrën e problemit, çështjes ose punës së trajtuar;</p> <p>3.5. nëse shpërblimi është i arsyeshëm bazuar në shpërblimet të cilat i kërkojnë ekspertët e ngjashëm gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme sipas këtij ligji. Shpërblimi i ekspertëve nuk mund të zvogëlohet me arsyen se kreditorët mund</p> | <p>including:</p> <p>3.1. the time spent on such services;</p> <p>3.2. the rates charged for such services;</p> <p>3.3. whether the services were necessary to the administration of, or beneficial at the time at which the service was rendered toward the completion of, a bankruptcy proceeding;</p> <p>3.4. whether the services were performed within a reasonable amount of time commensurate with the complexity, importance, and nature of the problem, issue, or task addressed; and</p> <p>3.5. whether the compensation is reasonable based on the customary compensation charged by comparably skilled practitioners in cases other than cases under this Law. The compensation of experts may not be reduced because creditors may not be paid in full.</p> | <p>3.1.vreme provedeno u pružanju tih usluga;</p> <p>3.2.fakturisanje tarife za pružene usluge;</p> <p>3.3.da li su usluge koje je pružio profesionalac bile neophodne i korisne za uspešno okončanje stečajnog postupka;</p> <p>3.4.da li su usluge bile pružene u okviru razumnog vremena, imajući u vidu složenost, važnost i prirodu problema, pitanja ili tretiranog posla; i</p> <p>3.5.da li je nadoknada razumna, zasnovana na uobičajenoj nadoknadi koju traže veštaci i slično tokom tretiranja sličnih slučajeva u skladu sa ovim zakonom. Nadoknada veštaku se ne može smanjiti uz obrazloženje da poverioci mogu da ne budu isplaćeni u potpunosti.</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|---|---|
| <p>të mos paguhen në tërësi.</p> <p>4. Gjykata nuk do të lejojë shpërblim për:</p> <p>4.1. përsëritjen të panevojshëm të shërbimeve të njëjta;</p> <p>4.2. shërbimet nuk janë për përfitimin e pasurisë falimentuese ose nuk janë të nevojshme për administrimin e rastit.</p> <p>5. Kur gjykata e aprovon kërkesën e ekspertit për shpërblim dhe për rimbursim të shpenzimeve, të gjitha shumat e paguara ekspertit do të konsiderohen shpenzime administrative.</p> <p>6. Shpërblimi i ekspertit do të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Ekspertët Gjyqësor.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI V KËRKESAT E KREDITORËVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 44</p> | <p>4. The court shall not allow compensation for:</p> <p>4.1. unnecessary duplication of services; or</p> <p>4.2. services that were not reasonably likely to benefit the bankruptcy estate or were not necessary to the administration of the case.</p> <p>5. If the court grants the expert's request for fees and reimbursements, the amounts so approved shall be administrative expenses.</p> <p>6. The compensation of the expert will be made in accordance with the provisions of the Law in force on Judicial Experts.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER V CREDITORS' CLAIMS</p> <p style="text-align: center;">Article 44 Acceleration of Maturity of All Claims</p> | <p>4. Sud neće odobriti nadoknadu za:</p> <p>4.1. nepotrebno dupliranje istih usluga; ili</p> <p>4.2. usluge koje nisu korisne za stečajnu masu ili nisu neophodne za upravljanje predmetom.</p> <p>5. Ukoliko sud odobri zahtev veštaka za nadoknadu i pokriće troškova, svaka suma isplaćena profesionalcu smatraće se administrativnim troškovima.</p> <p>6. Naknada veštaka će se vršiti u skladu sa odredbama važećeg Zakona o sudskim veštacima.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE V POTRAŽIVANJA POVERILACA</p> <p style="text-align: center;">Član 44. Ubrzanje dospevanja svih potraživanja</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p style="text-align: center;">Arritshmëria e të gjitha kërkesave</p> <p>Kërkesat e pa arritura (pa-maturuara) do të konsiderohen të arritura (maturuara) në momentin kur gjykata vendos për hapjen e rastit të falimentimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 45</p> <p style="text-align: center;">Definimi i kërkesës së siguruar</p> <p>1. Një kërkesë konsiderohet kërkesë e siguruar deri në vlerën e kolateralit që siguron pagesën e kërkesës;</p> <p>2. Nëse kërkesa e kreditorit e tejkalon vlerën e kolateralit që siguron pagesën e kërkesës, konsiderohet se kreditori për pagesën mbi vlerën e kolateralit ka kërkesë të pasiguruar.</p> <p>3. Nëse një palë e interesuar e konteston vlerën e kërkesës së siguruar, gjykata:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1.e bënë vlerësimin e kolateralit të kreditorit pas hapjes së rastit;</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2 .e përcakton vlerën e kolateralit në përputhje me qëllimin e vlerësimit të</p> | <p>The opening of a case shall accelerate the maturity of all unmatured claims to the date the case was opened.</p> <p style="text-align: center;">Article 45</p> <p style="text-align: center;">Definition of Secured Claim</p> <p>1.A claim is a secured claim only to the extent of the value of the collateral securing its repayment.</p> <p>2. To the extent that a creditor’s claim exceeds the value of the creditor’s collateral, the creditor holds an unsecured claim for the excess.</p> <p>3.If a party in interest disputes the amount of a secured claim the court:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1. shall value a creditor’s collateral as of the opening of the case;</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2. shall determine such value in light of the purpose of the valuation and of the proposed disposition or use of such collateral;</p> | <p>Potraživanja koja nisu dospela smatraće se dospelim u trenutku kada sud donese odluku o otvaranju stečajnog predmeta.</p> <p style="text-align: center;">Član 45.</p> <p style="text-align: center;">Definicija obezbeđenog potraživanja</p> <p>1.Potraživanje se smatra obezbeđenim do vrednosti garancije koja obezbeđuje njegovu isplatu.</p> <p>2.Ukoliko potraživanje poverioca prevazilazi vrednost garancije koja obezbeđuje isplatu potraživanja, smatra se da poverilac, za isplatu vrednosti garancije, ima neobezbeđeno potraživanje.</p> <p>3.Ukoliko zainteresovana stranka ospori iznos obezbeđenog potraživanja, u tom slučaju sud:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1.vrednuje garanciju poverioca u momentu otvaranja predmeta;</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2.određuje vrednost garancije u saglasnosti sa svrhom vrednovanja i načinom korišćenja ove garancije;</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>kolateralit dhe natyrën e përdorimit të kolateralit;</p> <p>3.3. e përcakton vlerën e kolateralit në seancë dëgjimore, ku kreditori i prekur nga vlerësimi mund të jap informata për natyrën e përdorimit të kolateralit ose planin që mund të ndikojë drejtpërdrejtë te kreditori.</p> <p style="text-align: center;">Neni 46 Kompensimi i kërkesave</p> <p>1. Pas inicimit të procedurës së falimentimit, kompensimi i ndërsjellë i kërkesave në mes të debitorit dhe kreditorit lejohet vetëm gjer në shkallën e përcaktuar me këtë nen.</p> <p>2. Jashtë kompensimit të kërkesave që përfshijnë llogaritë bankare, kreditori mund të kompensojë një kërkesë që ka ndaj debitorit, nëse kërkesa:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. ka ekzistuar brenda gjashtë muajve nga hapja e rastit,dhe</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2.kreditori i dërgon njoftim me shkrim përfaqësuesit të pasurisë falimentuese para skadimit të afatit të regjistrimit të kërkesave dhe provave mbi ekzistimin e</p> | <p>3.3. determines the value of the collateral in a hearing, where the creditor affected by the assessment can provide information about the nature of the use of the collateral or the plan that may directly affect the creditor.</p> <p style="text-align: center;">Article 46 Setoff of claims</p> <p>1. After the commencement of bankruptcy proceedings, a creditor may set off a claim against the debtor with a claim it owes the debtor only as provided in this Article.</p> <p>2. Other than for setoffs involving bank accounts, a creditor may setoff a mutually held claim against the debtor if that claim:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. was in existence within the six (6) months prior to the opening of the case; and</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. the creditor provides written notice of the setoff to the bankruptcy estate representative before the expiration of the period to file proofs of claim.</p> | <p>3.3.određuje vrednost garancije na raspravi, kada poverilac koji je pogođen procenom može dati informacije o prirodi upotrebe garancije ili plan koji može direktno da utiče na poverioca.</p> <p style="text-align: center;">Član 46. Prebijanje potraživanja</p> <p>1.Nakon započinjanja stečajnog postupka, uzajamna nadoknada potraživanja između dužnika i poverioca dozvoljeno je samo do nivoa koji je određen ovim članom</p> <p>2.Pored naplaćivanja potraživanja koja obuhvataju račune u banci, poverilac može naplatiti potraživanje prema dužniku ukoliko:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1.je potraživanje postojalo unutar 6 meseci pre otvaranja predmeta; i</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2.poverilac dostavi pismeno obaveštenje zastupniku stečajne mase pre isteka roka za registraciju potraživanja i dokaza o postojanju potraživanja.</p> |
|---|---|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p>kërkesave.</p> <p>3. Sa i përket llogarive bankare:</p> <p>3.1. pas hapjes së rastit, banka nuk mund të kompensojë asnjë detyrim që i ka debitorit ndaj asnjë detyrimi që ka debitori ndaj bankës;</p> <p>3.2. nëse banka ka bërë kompensimin ndaj bilancit në llogarinë bankare të debitorit për borxhet e debitorit ndaj saj gjashtë (6) muaj para hapjes së rastit falimentues., banka detyrohet ti kthejë pasurisë falimentuese diferencën në mes të:</p> <p>3.2.1. deficitit që ka ekzistuar gjashtë (6) muaj para hapjes së rastit shumën e detyruar ndaj bankës që ka tejkaluar vlerën e bilancit atë kohë; dhe</p> <p>3.2.2. deficitin e kalkuluar sipas nënparagrafit paraparak menjëherë pas kryerjes së kompensimit.</p> <p>4. Kërkesat që janë paraqitur para datës së hapjes së rastit nuk do të kompensohen</p> | <p>3. With respect to bank accounts:</p> <p>3.1. a bank may not setoff, after the opening of the case, any claim the bank owes the debtor such as a bank account against any claim the debtor owes the bank;</p> <p>3.2. if the bank set off any balance in a bank account against any claim owed to it by the debtor during the six (6) months prior to the opening of the case, the bank shall return to the estate the difference between:</p> <p>3.2.1. the deficiency existing six months prior to the opening of the case defined as the amount by which the claim owed to the bank exceeded the account balance after setoff; and</p> <p>3.2.2. the deficiency calculated as in the prior paragraph immediately after the setoff.</p> <p>4. Claims that have arisen prior to the opening of the case shall not be set off against claims that have arisen after the case is opened.</p> | <p>3.Što se tiče bankovnih računa:</p> <p>3.1.nakon otvaranje predmeta, banka ne može izvršiti prebijanje nijedne obaveze koju ima prema dužniku i bilo koje obaveze koju dužnik ima prema banci;</p> <p>3.2.Ukoliko je banka nadoknadila bilans na bankovnom računu dužnika za njegova dugovanja prema njoj, šest (6) meseci pre otvaranja stečajnog predmeta, banka se obavezuje da vrati stečajnoj masi:</p> <p>3.2.1.deficit koji je postojao šest (6) meseci pre otvaranja predmeta i dug prema banci koji je prevazišao tadašnju vrednost bilansa; i</p> <p>3.2.2.deficit obračunat u skladu sa prethodnim stavom, neposredno nakon kompenzacije.</p> <p>4.Potraživanja koja su se pojavila pre otvaranja predmeta neće biti prebijana u odnosu na potraživanja koja su nastala nakon otvaranja predmeta.</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|---|---|
| <p>kundrejt kërkesave që janë paraqitur pas datës së hapjes së rastit.</p> <p>5. Për qëllime të këtij neni, kompensim i kërkesave, nuk konsiderohet pagesa e obligimeve të rregullta që rrjedhin nga marrëveshjet kreditore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 47 Obligimi i kreditorëve për të ofruar dëshmi mbi kërkesën</p> <p>1. Secili kreditor duhet ta regjistrojë kërkesën dhe provat mbi ekzistimin e kërkesës në gjykatë, me qëllim të vërtetimit të vlefshmërisë dhe vlerës së kërkesës.</p> <p>2. Gjykata i ofron palëve një formë specifike për regjistrimin e kërkesës dhe provave për ekzistimin e kërkesës. Në mungesë të një forme specifike, kreditorët do të deponojë në gjykatë një deklaratë me shkrim e cila konsiderohet deklaratë nën betim që:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. përshkruan kërkesën, duke përfshirë informatën se a është kërkesa e pasiguruar, me prioritet ose e siguruar;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. përcakton shumën e saktë të kërkesës në ditën e hapjes së rastit të falimentimit;</p> | <p>5. For the purposes of this article, compensation of claims is not considered payment of regular obligations arising from loan agreements.</p> <p style="text-align: center;">Article 47 Creditors' Duty to File Proofs of Claim</p> <p>1. Each creditor must file a proof of claim with the court to establish the validity and amount of its claim.</p> <p>2. The court provides the parties with a specific form for registration of the claim and proves on existence of the claim. In absence of a specific form, the creditors shall file at the court a written statement which is considered statement under oath:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. describing the claim, including whether it is claim as unsecured, priority, or secured;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. setting forth its exact amount as of the date of the opening of the case;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. appending, if available, accurate</p> | <p>5. Naknadom potraživanja, u smislu ovog člana, ne smatra se plaćanje redovnih obaveza po osnovu ugovora o kreditu.</p> <p style="text-align: center;">Član 47. Obaveza poverioca za podnošenje dokaza o potraživanju</p> <p>1. Svaki poverilac mora da registruje u sudu potraživanje i dokaze o postojanju istog, kako bi se ustanovila validnost i vrednost potraživanja.</p> <p>2. Sud daje strankama specifičan obrazac za registraciju potraživanja i dokaza o postojanju istog. U nedostatku obrasca, poverioci prilažu sudu pismenu izjavu koja se smatra izjavom pod zakletvom koja :</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. opisuje potraživanje, uključujući i to dali je potraživanje osigurano, prioritarno ili neosigurano;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. utvrđuje njegov tačan iznos na dan otvaranja stečajnog predmeta;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. prilaže tačne i kompletne kopije,</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p>2.3. t'i bashkëngjis kopjet e sakta dhe të plota të dokumentacionit përcjellës në lidhje me atë kërkesë ose barrë që lidhet me atë kërkesë, nëse këto janë të aplikueshme.</p> <p>3. Nëse kreditori nuk e provon me prova konkrete ekzistimin e kërkesës, ai nuk do të mund:</p> <p>3.1. të marrë pjesë në shpërndarjen e pasurisë falimentuese për kreditorët;</p> <p>3.2. të marrë pjesë në komitetet e kreditorëve;</p> <p>3.3. të votojë për planin e riorganizimit.</p> <p>4. Në procedurë të likuidimit, kreditori duhet të regjistrojë kërkesën sipas këtij neni në afatin prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit për hapjen e procedurës së falimentimit.</p> <p>5. Në raste të riorganizimit, përveç kur gjykata urdhëron ndryshe për shkak të nevojave të procedurës së riorganizimit, kreditori duhet të paraqes dëshmi mbi</p> | <p>and complete copies of the documents related to the claim or to any security related to such claim.</p> <p>3. If the creditor fails to provide proofs of claim, it will not be able to:</p> <p>3.1. share in any distribution of property of the bankruptcy estate to creditors;</p> <p>3.2. serve on any creditors' committee; or</p> <p>3.3. vote on any plan of reorganization.</p> <p>4. In a liquidation case, a creditor must file a proof of claim within sixty (60) days of the date of the notice of the opening of the bankruptcy proceeding.</p> <p>5. In a reorganization case, unless the court orders otherwise according to the needs of the reorganization, a creditor must file a proof of claim within thirty (30) days of the date of the notice of the opening of the bankruptcy proceeding.</p> | <p>propratne dokumentacije u vezi sa tim potraživanjem ili sa zalogom koji se povezuje s njim, ukoliko su primenljive.</p> <p>3.Ako poverilac ne priloži dokaze o potraživanju, neće moći da:</p> <p>3.1.učestvuje u bilo kakvoj raspodeli imovine stečajne mase u korist poverilaca;</p> <p>3.2.učestvuje u odborima poverilaca;</p> <p>3.3.glasa za plan reorganizacije.</p> <p>4.U postupku likvidacije, poverilac treba da registruje potraživanje u roku od šezdeset (60) dana od dana obaveštenja o otvaranju stečajnog postupka.</p> <p>5.U postupku reorganizacije, osim ako sud naloži drugačije zbog potreba reorganizacije, poverilac treba da registruje potraživanje u roku od trideset (30) dana od dana prijema obaveštenja o otvaranju stečajnog postupka.</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p>kërkesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit për hapjen e procedurës së falimentimit.</p> <p>6. Deri në tridhjetë (30) ditë pas kalimit të afateve të parapara në paragrafët 4 dhe 5, të këtij neni përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të paraqes dëshmi për ekzistimin e kërkesës në emër të cilitdo kreditor, duke vepruar me mirëbesim.</p> <p>7. Regjistri i kërkesave është i hapur për publikun gjatë orarit të rregullt të punës së gjykatave dhe gjykata lejon përmes procedurave të arsyeshme, inspektimin, fotokopjimin dhe çasjen e atyre të dhënave nga publiku.</p> <p style="text-align: center;">Neni 48 Procedura ndaj kërkesave</p> <p>1. Provat për kërkesën të regjistruara në përputhje me këtë ligj konsiderohen provat që supozojnë vlefshmërinë dhe vlerën e kërkesës së kreditorit dhe të barrës mbi atë kërkesë. Nëse nuk ka ndonjë kundërshtim të kërkesës, kreditori nuk ka nevojë të ndërmarr veprime shtesë dhe kërkesa do të konsiderohet e lejueshme.</p> | <p>6. Within thirty (30) days of the deadline for filing proofs of claim as provided in paragraphs 4 and 5 of this Article has passed, the bankruptcy estate representative may file a proof of claim on behalf of any creditor. Such filing must be made in good faith.</p> <p>7. The claims register shall be open to the public when the court is open, and the court shall allow for reasonable procedures for the inspection and copying of all documents contained in the register.</p> <p style="text-align: center;">Article 48 Claim Procedure</p> <p>1. A proof of claim filed in accordance with this law shall constitute presumptive proof of the validity and the amount of a creditor's claim, and of any security for that claim. If there is no objection to the claim, the creditor needs to take no further action to establish any part of the claim, and the claim shall be deemed allowed.</p> <p>2. A party in interest may object to a proof</p> | <p>6. Do trideset (30) dana nakon isteka rokova iz stavova 4 i 5 ovog člana, zastupnik stečajne mase registruje dokaz o postojanju potraživanja u ime bilo kog poverioca. delujući u poverenju.</p> <p>7. Registar potraživanja je otvoren za javnost u toku redovnog radnog vremena sudova. Preko razumnih procedura sud dozvoljava inspekciju, fotokopiranje i pristup javnosti tim podacima.</p> <p style="text-align: center;">Član 48. Procedura potraživanja</p> <p>1. Dokazi o potraživanjima registrovanim u skladu sa ovim zakonom smatraju se dokazima koji pretpostavljaju važnost i vrednost potraživanja poverioca i zalogu na njega. Ukoliko nema prigovora na potraživanje, poverilac ne mora da preduzima dodatne radnje i potraživanje se smatra dozvoljenim.</p> <p>2. Zainteresovana stranka može osporiti</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|---|--|
